



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 18.03.2026

Numër Protokoli: 1405/2026

A.nr.1832/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1832/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi O.V, kundër organit të punësimit: Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.1832/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi O.V.
- II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

## A r s y e t i m

Ankuesi O.V (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 22.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.58/2025, të datës 22.09.2025, të Komisionit Disiplinor të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, **sepse**:

Nga shkresat e lëndës del së ankuesi ushtron pozitën e punës Kryetar i Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (tutje KRRPP).

Tutje nga provat e lëndës rrjedhë se ankuesi më datë 30.06.2025, kishte parashtruar kërkesë pranë Komisionit Disiplinor për inicim të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil Sh.N, në pozitën e Drejtorit të IT-së në KRRPP-së, për shkak të supozimit për shkelje të rënda disiplinore siç janë tejkalim i kompetencave të tij zyrtare, përkatësisht ndërhyjë e paautorizuar në kompetencat e të tjerëve dhe krijimi të një ambienti konfliktuoz në institucion, ndërsa, Komisioni Disiplinor më Vendimin nr.58/2025, të datës 22.09.2025, ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 30.06.2025 për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarit Sh.N.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr.58/2025, të datës 22.09.2025, të Komisionit Disiplinor të KRRPP-së, për shkak të shkeljeve procedurale, cenimit të të drejtave të palës ankuese dhe vlerësimit të gabuar të provave. Kërkon që të shfuqizohet Vendimi Nr.58/2025 i datës 22.09.2025, të Komisionit Disiplinor të KRRPP-së si i paligjshëm dhe çështja të kthehet në rishqyrtim të një komision tjetër disiplinor i paanshëm dhe i pandikuar.

Kolegji i Këshilli në kuptim të kompetencës së Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative iu referuar nenit 3, paragrafi 1 dhe nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë (LZP), më të cilat dispozita është përcaktuar se: **Neni 3:** *1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji; 1.4. të emëruarat/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji, .* **Neni 5 :** *1.Kategoritë e zyrtarëve/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Kryesuesja/i dhe përformuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë..” dhe si rrjedhojë e këtij kuadri ligjor rezulton fakti i pakontestueshëm se funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të ligjit për zyrarët publikë, rrjedhimisht, të njëjtit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil sipas nenit 5 paragrafi 2 të LZP. Andaj, duke qenë se sipas nenit 86.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është agjenci e pavarur rregullatore, ndërsa, sipas nenit 89.2 të këtij ligji Kryetari i KRPP-së është funksionar publik që propozohet nga Qeveria*

e Republikës së Kosovës dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kolegji konstaton së ankuesi në pozitën e kryetarit të KRRPP-së nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që, nisur nga fakti se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, juridiksion ky i përcaktuar me nenin 102 të Kushtetues së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton së KPSHCK-ja nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejte kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore të Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 78 dhe 79 ka përcaktuar: Neni 78, paragrafi 1” 1. *I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.*

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën dhe meqenëse në rastin konkret nuk ka organ te brendshëm që trajton kërkesa të natyrës së tillë, atëherë pala ankuese udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi, nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Numri i lëndës: A.nr.1832/2025

Datë: 18.03.2026

Numër protokollit: 1405/2026

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

*Lënda me numër A.nr.1832/2025*

**Merlinda RAMAJ**

\_\_\_\_\_  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

\_\_\_\_\_  
Kryetare e Kolegjit

### **Vendimi i dorëzohet:**

- *Ankuesit, O.V;*
- *Njesisë së BNJ të KRRPP-së dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*